



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 444 | Prot
5

Tiranë, më 09/4 /2021

VENDIM

Nr. 21, datë 09.4 .2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 444 Prot., datë 05.03.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Bulqizë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit nëpërmjet e-mail-it datë 19.02.2021, depozituar në adresën elektronike arseolamulia@yahoo.com, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

- *Listën e plotë të të punësuarve në Bashkinë Bulqizë dhe institucionet nën varësi të saj apo në ato shoqëri aksionere ku Bashkia Bulqizë zotëron 100% të kapitalit: emër - mbiemër dhe pozicionin e punës që mban. Lista të shoqërohet edhe me emërtimin e organikës ose departamentet përkatëse.*

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, (në vijim LDI).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 444/1 prot., datë 11.03.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 17.03.2021.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1176/1 Prot., datë 12.03.2021, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me shkresën nr. 444/2 Prot., datë 17.03.2021 ka kthyer përgjigje duke argumentuar se: *“Informacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion pasi konsiderohet konfidencial, bazuar në VKM-në nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personalit”. Gjithashtu, bashkëngjitur shkresës ka vendosur në dispozicion Vendimin Nr.732 Prot., datë 12.02.2021 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 189, datë 12.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë mbi miratimin e strukturës/organikës/kategoritë/nivelin e pagave/klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së bashkisë dhe njësave shpenzuese në varësi të Bashkisë Bulqizë për vitin 2021”, i cili gjendet edhe në faqen zyrtare të Web-it të bashkisë”*.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga ana e Autoritetit Publik, ankuesi me shkresën nr. 444/3 Prot., datë 17.03.2021, ka vijuar ankimin me pretendimin se, *“informacioni i kërkuar nuk është konfidencial, pasi nuk kam kërkuar të dhëna që kanë të bëjnë me konfidencialitetin apo të dhëna personale të dosjes së punonjësve, por vetëm listën e plotë të punonjësve që është informacion publik”*.

Në vijim, Autoriteti Publik me shkresën nr. 1176/2 Prot., datë 24.03.202, ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur më parë.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik dhe argumenti i dhënë për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndron.

Informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*. Si rrjedhojë, në kushtet kur Autoriteti Publik disponon informacionin e kërkuar, është përgjegjës për vënien e tij në dispozicion të kërkuarit.

Lidhur me argumentin e parashtruar nga ana e Autoritetit Publik, se informacioni i kërkuar, bazuar në VKM-në nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personalit” konsiderohet konfidencial, nuk qëndron. Në parim, aksesimi dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në qëndrimin e Autoritetit Publik konstatohet se kufizimi i aksesit është bërë në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, pa marrë parasysh dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Bazuar në shkronjën b) të pikës 4 të nenit 4 të ligjit të sipërcituar, ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Në nenin 15 të tij “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”, në të cilin parashikohet se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre”.

Gjithashtu, sqarojmë se bazuar në pikën 5, fusha 1, të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.9.2018 të Komisionerit, “Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, në pikën 5, Administrata e bashkisë përfshin bërjen publike të - Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë”. Për rrjedhojë, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se informacioni i kërkuar nga ankuesi konsiderohet informacion publik dhe nuk rezulton t’i nënshtrohet kufizimit ligjor të parashtruar nga Autoriteti Publik për mosdhënien e tij.

Ligji për të drejtën e informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Në lidhje me trajtimin e praktikës, nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konstatohet se personi që ka trajtuar kërkesën për informacion dhe ka nënshkruar kthim përgjigjen është Sekretari Përgjithshëm i Autoritetit Publik. Bazuar në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe të Vendimit Nr. 119, datë 13.01.2020 “Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin, detyrat dhe kompetencat lidhur me veprimtarinë e administratës së bashkisë

dhe institucioneve në varësi të saj”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit Publik, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil, ka refuzuar dhënien e informacionit.

Bazuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, refuzimi për dhënien e informacionit përbën shkelje administrative, e cila dënohet me gjobë, që varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 2 dhe 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, nr. 444 Prot., datë 05.03.2021, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Bulqizë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 19.02.2021, konkretisht:
 - *Listën e plotë të të punësuarve në Bashkinë Bulqizë dhe institucionet nën varësi të saj apo në ato shoqëri aksionere ku Bashkia Bulqizë zotëron 100% të kapitalit: emër - mbiemër dhe pozicionin e punës që mban. Lista të shoqërohet edhe me emërtimin e organikës ose departamentet përkatëse, brenda datës 16 . 4 .2021.*
3. Dënimin e Sekretarit të Përgjithshëm në Autoritetin Publik, z. Leonard Daçi, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjopa ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni

administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

6. Ky vendim u shpall sot në datë 09. 4 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

